



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21) dhe nenit 23, paragrafi 2 të Ligjit të Veprimtarisë me Valuta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët që nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 247/21)

1. Në Vendimin për mënyrën dhe kushtet sipas të cilave rezidentët të cilët nuk janë banka të autorizuar, mund të çelin dhe të kenë llogari jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 42/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 50/19, 181/19, 167/20, 308/20, 88/21 dhe 177/21), në pikën 2, pas nënpikës 2.13 shtohet nënpikë e re 2.14, si më poshtë:

"2.14 Personat fizikë me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për dërgesë në shumë të caktuar për të marrë dokumentin për qëndrim të përkohshëm jashtë vendit, për nevoja arsimore.

Detyrimi nga paragrafi 1 të kësaj nënpike dëshmohej me dokument të lëshuar nga institucioni arsimor kompetent i huaj, organi kompetent i huaj, përfaqësia diplomatiko-konsullore e shtetit të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me të cilën vërtetohet se, për lëshimin e dokumentit për qëndrim të rregulluar në atë vend, për qëllime shkollimi, rezidenti duhet fillimisht të çelë një llogari në një bankë të huaj dhe të tregojë shumën e saktë të mjeteve në llogari.

Llogaria e hapur mbi këtë bazë mund të çelet vetëm në shtetin nga i cili është lëshuar dokumenti nga institucioni kompetent arsimor i huaj, organi kompetent i huaj, përfaqësia diplomatiko-konsullore e shtetit të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mund të shfrytëzohet për transferimin e mjeteve në dhe nga jashtë".

2. Në pikën 3, paragrafi 1, pas numrit: "2.10", lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje, ndërsa pas numrit: "2.12" shtohet lidhëza "dhe" dhe numri "2.14".

3. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

O nr. 02-15/XVI-2/2021
1 nëntor 2021
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska